

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Hasan Shala dhe Ramiz Kuqi , anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, “A-P”, me seli në ..., Komuna F. Kosovë, kundër të paditurës Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale-Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës,(MPMS-TEIP), me bazë juridike anulimi i aktit administrativ lidhur me shqiptimin e gjobës, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë, A.nr.239/13, të datës 04.03.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.07.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, “A-P, me seli në f. ..., Komuna Fushë Kosovë.

Vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për çështje Administrative, A.nr.239/2013, i datës 04.03.2016.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si jo të bazuar , ushtruar kundër të paditurës Ministria për Punë dhe Mirëqenies Sociale-Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit nr.76/2012,të dt.27.12.2012.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka paraqitur ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, në arsyetim ndër të tjera thekson se; nuk janë vlerësuar fare të thënat e theksuara në mbrojtje e paditëses, po ashtu paditësja me kohë dhe në tërësi të caktuar nga inspektorët ka vepruar sipas vërejtjeve të inspekcionit, ka eliminuar në tërësi parregullsitë e pretenduara duke e harmonizuar rregulloren e punës të kompanisë me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, po ashtu shkelje e së drejtës materiale konsiston me faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me mbikëqyrje administrative, prandaj akti me të cilin është gjobitur paditësja nuk konsiderohet akt administrativ kundër të cilit mund të zhvillohet konflikt administrativ, se në rastin e konkret kemi të bëjmë me kontrollin e mbrendshëm dhe me këtë akt nuk është vendosur për të drejtat dhe obligimet e palëve, prandaj akti për gjobitjen e paditëses nuk mund të konsiderohet akt administrativ-kundër të cilit mund të zhvillohet konflikti administrativ, etj. Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe të refuzohet kërkesa e inspektorëve të punës, si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative(LKA), nenit 194 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore, ligj i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës vlerëson se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e MPMS-TEIP, në Prishtinë, nr.76/2012,të datës 27.12.2012, është refuzuar ankesa e paditësit si jo e bazuar, paraqitur kundër vendimit të inspektorëve të punës me 01 nr. 08-166-3/12 të datës 29.11.2012 me të cilin paditësit i është shqiptuar gjoba në shumë prej 2.300€, në bazë të nenit 92 të Ligjit për punë nr.03/L-212 dhe neni 15 i Ligjit nr.2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe të punësuarve dhe ambientit të punës, neni 5 të Ligjit nr 03/L-017, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës nr.2002/9, për shkak të parregullsive të gjetura dhe konstatuara me rastin e kontrollit të inspektorëve të punës, ku në raportet zyrtare të inspektorëve të punës 01 nr.166-1/2012 të datës 18.12.2012, kanë konstatuar gjendjen faktike, se paditësi nuk ka respektuar nenin 95 të Ligjit Nr. 03/L-212 i punës të Kosovës, nenin 2 par.2.4 të Ligjit nr. 2003/19, për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, po ashtu me raporte zyrtare i është dhënë vërejtja që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh të bëjë eliminimin e parregullsive të konstatuar nga inspektori i punës, dhe gjatë riinspektimit të datës 12.11.2012,dhe dhënies së afatit të serishëm shtesë sipas konkluzionit të TEIP, paditësi nuk ka eliminuar parregullsitë e konstatuara si në raportet zyrtare, andaj i është shqiptuar masa ndëshkuese me gjobë..

Kundër vendimit përfundimtar të organit administrativ paditësi me padi inicon konflikt administrativ në procedurë gjyqësore, gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave të theksuara si në aktgjykimin e saj, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, duke iu referuar dispozitave ligjore sipas Ligjit për punë, dhe dispozitave të Ligjit për sigurinë në punë mbrojtjen e shëndetit dhe të ambientit në punë, nr.2003/13, neni 2.1, ka gjetur se padia e paditësit është e pa bazuar, Vendimin kontestues të TEIP, e vlerëson të drejtë dhe të bazuar në ligj, të arsyetuar qartë dhe kuptueshëm për fakte vendimtare ; se e paditura TEIP, me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit, bazohet në të gjeturat e inspektoratit të punës të cilat janë të konstatuara dhe dëshmuara me rastin e kontrollit të bërë nga ana e inspektorëve të punës të përshkruara më hollësisht në raportin zyrtar, 01 Nr.166, të datës 18.10.2012, ku pas inspektimit të paditësjë, inspektorët e punës kanë konstatuar 2 parregullsi, për eliminimin e këtyre parregullsive paditëses i është dhënë vërejtje për eliminimin e tyre në afat prej 15 ditësh, por edhe pas këtij afati nuk është ndërmarrë kurrfarë mase për eliminimin e tyre, dhe pas ri inspektimit të dt.12.11.2012, pala paditëse nuk është përgjigjur fare.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, nga se, me rastin e refuzimit të kërkesë padisë së paditësit në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale dhe procedurale ,dhe drejtë është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit të organit të paditur si në vështirim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së sepse organi administrativ i shkallës së parë i-TEIP , tek punëdhënësi –paditësi ,i ka hasur dhe evidentuar parregullsitë e cekura si në Vendimet e theksuara më lartë, se i njëjti rregulloren e punës e ka pasur jo në harmoni me ligjin e punës (neni 95),si dhe nuk ka bërë vlerësimin e ekzistimit të vendeve të punës me rrezikshmëri të lartë ndërsa parregullsitë e cekura nuk i ka eliminuar dhe nuk i ka dërguar dëshmitë e kërkuara tek ky organ në afatet e dhëna si në raportin e ri inspektimit dhe Konkluzionit të TEIP.

Pretendimet ankimore të paditësit të theksuara si më lartë si dhe theksimet e tjera, kolegji i shqyrtoi me kujdes dhe vlerëson se janë të pa bazuara në drejtim të vërtetimit të gjendjes faktike të

çështjes në shqyrtim, dhe jo me ndikim për vendosjen ndryshe sepse aktgjykimi i goditur nuk është i përfushë me shkelje esenciale të dispozitave të LKA e po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë si në vendimet e organi të paditur të konfirmuara si ligjore dhe në procedurë gjyqësore, sepse paditësi nuk i ka eliminuar parregullsitë e hasura në afatet e caktuara nga TEIP. Ndërsa po ashtu janë të pa qëndrueshme pretendimet se akti me të cilin është gjobitur nuk është akt administrativ dhe me këtë akt nuk vendoset për të drejtat dhe obligimet e palëve etj ,sepse çështja në shqyrtim është kompetencë e gjykatës në procedurë të konfliktit administrativ sepse është atakuar akti përfundimtar i organit administrativ, vendimi i MPMS-TEIP, i cili është organ si parashihet në nenin 3,par.1,pika 1.1 të Ligjit për konflikte administrative, dhe me kompetencë sipas pretendimeve në kërkesë padi të paditësit gjykata ka vlerësuar ligjshmërinë e tij, i cili po ashtu është akt administrativ ashtu si parashihet në nenin 3 par.1 pika 1.2., të LKA, i nxjerrë si Vendim përfundimtar në procedurë administrative.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kolegji i gjykatës së apelit konstaton se në këtë çështje juridike administrative, nga organi administrativ përfundimtar, MPMS-TEIP, dhe gjykata e shkallës së parë drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila rezulton se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, aktgjykimi i ankimuar është i kuptueshëm përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i miraton edhe kolegji duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë, andaj i njëjti vërtetohet në tërësi si i drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe nenit 200 i LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
A.A.nr.146/2016,me datë 20.07.2016

Kryetari i kolegjit
Ragip Namani